



DITARI I NATYRËS

Nr. 85 - Qershor 2020 / viti i tetë i publikimit



Peshkatarët kërkojnë mbështetje nga shteti

Pasioni dhe nevoja është ajo që e bën një peshkatar të vazhdojë të punojë, por nevoja për mbështetje, ligj funksional, kontroll të peshkimit industrial dhe sportiv janë...

[Për më tepër...](#)



Deti, e ardhmja e gjithë rajonit - Rimëkëmbja Blu e Mesdheut

Në rajonin mesdhetar, të shkatërruar nga epidemia e COVID-19 dhe që po përpiqet të nisë një sezon turistik jo shumë premtues për 2020, në Ditën Botërore të Oqeanëve, WWF lançon një thirrje për 22 vendet dhe territoret bregdetare, për të punuar së bashku për një "Strategji të Rimëkëmbjes Blu" për Rajonin.

[Për më tepër...](#)



"Pasditja Ime" Dita botërore e deteve dhe oqeanave "9 Qershor 2020"



Zonat e Mbrojtura dhe COVID-19

Si po ndikon Covid 19 mbi komunitetin mbarëbotëror, mbi jetën dhe shëndetin e njerëzve, mënyrën e jetesës, ekonominë, natyrën dhe përjasjen tonë ndaj tyre...

[Për më tepër...](#)

Si duhet të sillemi në një Zonë të Mbrojtur

Gjithnjë e më tepër njerëzit preferojnë të vizitojnë e shijojnë natyrën. Zonat e mbrojtura mirëpresin me dhjetëra vizitorë çdo ditë. Por a dimë të sillemi si duhet me natyrën? A jemi të sigurt se vizita jonë nuk ndikon negativisht mbi vlerat natyrore?

[Për më tepër...](#)



Është koha për Natyrën

Dita Botërore e Mjedisit sjell ndërgjegjësim nëpërmjet përfshirjes së komunitetit në mbrojtjen e mjedisit. Të rinjtë e mbledhur në Peisazhin e Mbrojtur të lumit Buna, përcollën mesazhin e ditës "Është koha për Natyrën" me aktivitetet e zhvilluara me synim angazhim me aktiv dhe të përgjegjshëm të përdoruesve të kësaj ZM për të ruajtur vlerat natyrore të saj.

[Për më tepër...](#)

Oferta 3B në Velipojë

Eco Guest House 3 B (Bed & Breakfasts & Birdwatching) është modeli më i ri i ofertës turistike në Velipojë.

[Për më tepër...](#)



Një mundësi më shumë për turizmin natyror

Ata që dëshirojnë të shijojnë bukuritë natyrore dhe biodiversitetin e lartë të fshatit turistik Baks-Rrjoll, parë nga një këndvështrim tjetër, mund të vizitojnë shtegun Rrjoll Maja e Zezë. Ngjitja në mal mundëson një pamje në 360 grade të zonës duke ofruar një mozaik peisazhesh të mrekullueshëm.

[Për më tepër..](#)

Ekosistem Inovativ të menaxhimit të mbetjeve

Iniciativave ekzistuese ricikluese, duke krijuar një platformë dixhitale rajonale të menaxhimit të mbetjeve të ngurta jo të rrezikshme, të prodhura dhe të përdorura nga industritë e ndryshme, do t'i bashkangjitet dhe përdorimi i ekosistemit dixhital SWAN për të shfrytëzuar mundësi të reja ricikluese, të cilat mund të mos jenë ekonomisht të arritshme lokalisht, por mund të jenë të arritshme në aspektin rajonal.

[Për më tepër..](#)



Data të rëndësishme...

5 Qershor

Dita Botërore e Mjedisit

Koha për Natyrën

Sipas propozimeve të Konferencës së Stokholmit, Asambleja e 27-të e OKB-së vendosi të krijojë "Programin e Mjedisit" dhe caktoi zyrtarisht 5 Qershorin si "Ditën Botërore të Mjedisit".

[Për më tepër...](#)





8 Qershor

Dita Botërore e Oqeaneve

E festuar çdo vit në 8 qershor që nga viti 2009, Dita Botërore e Oqeaneve është një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin global mbi sfidat që përballon komuniteti lidhur me oqeanet.

[Për më tepër...](#)

Pak Histori...

...2 vjet më parë ...

...Miratohet VKM Për shpalljen e ekosistemit natyror Krastë-Verjor "Peizazh i Mbrojtur" - [VKM Nr. 468, dt.26.07.2018...](#)

...6 vjet më parë ...

...U shpall Moratoriumi i Gjetisë në Republikën e Shqipërisë - [Ligji Nr. 7/2014...](#)

...8 vjet më parë ...

...Ekosistemi natyror i Malit të Tomorrit shpallet Park Kombëtar - [VKM nr. 472, dt.18.07.2012...](#)

...14 vjet më parë ...

...Shpallet Ligji "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit" - [Ligji nr.9587, dt.20.07.2006...](#)

...20 vjet më parë ...

...Me miratimin e [ligjit nr.8556, dt.22.12.1999](#), Shqipëria bëhet palë e Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkretëtirëzimin" (UNCCD) më 26.07.2000.

Për të lexuar Ditari i Natyrës në vite...[Kliko këtu!!!](#)

Udhëzime për të kontribuar në [Ditarin e Natyrës](#)



*Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti, Ilirjan Qirjazi, Vilma Kadiu, Ergi Petanaj*

*Copyright © 2020 INCA - All rights reserved
Adr.Rruga "Islam Alla", Pallati IVEA, Kati I, 1001
TIRANA - ALBANIA*